



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin



Shkurt, 2020

Vizitë e Ministres Hykmete Bajrami në SBASHK

Angazhime të përbashkëta të MASHT-it dhe SBASHK-ut në shërbim të arsimit



Me të marrë të detyrës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria Hykmete Bajrami, e shoqëruar nga Këshilltari i lartë Lulëzim Krasniqi, ka vizituar selinë e SBASHK-ut. Ata janë pritur nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe udhëheqës të tjerë të SBASHK-ut.

Duke shprehur respektin e lartë këtë vizitë, kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala dhe menaxherin për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri ... (faqe 4)

U mbajt takim konsultativ me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve

Marrëveshje për angazhime të përbashkëta sindikale



Është mbajtur në Sallën e takimeve të Qendrës së Studentëve takimi i rregullt konsultativ me ... (faqe 7)

Vazhdon realizimi i agjendës së takimeve nëpër komunat e Kosovës


Kuvende pune në Vushtrri e në Mitrovicë



Ka vazhduar realizimi i agjendës së ... (faqe 8)

Intervistë me zyrtaren për administratë në SBASHK, Afërdita Ahmeti

Respekti i ndërsjellë me anëtarët e SBASHK-ut më bën krenare



Afërdita Ahmeti është zyrtare administrative (faqe 3)

U mbajtën Kuvende pune në Obiliq dhe në Podujevë

Mirënjohje për arritjet, unik e të vendosur edhe në të ardhmen



Agjenda e përgatitur bashkërisht nga stafi qendror dhe kryetarët e niveleve sindikale komunale ... (faqe 4)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Respekt për misionin e tyre të shenjtë nëpër vite e dekada



Po afrohet muaji mars. Ky muaj te shqiptarët kthen kujtesën në shumë ngjarje e data të mëdha. Në fillimet e çdo marsi populli ynë lartëson kujtimin për Komandantin legjendar Adem Jashari dhe për Epopenë e lavdishme të UÇK-së. Mësuesi në mars lartëson kujtimin edhe për pishtarët e parë të dijes dhe shkollën e parë shqipe. Kujton kështu me respekt emrat e nderuar të mësuesve të parë, që nisen rrugëtimin e gjatë e plotë mundime e sakrifica për në misionin e shenjtë të arsimit e edukimit shqip të brezave.

Duke bërë përgatitje për të shënuar në mënyrë sa më madhështore 7 Marsin, njeriu vetvetiu shpalos faqet e historisë së ndritur të arsimit shqip. Duke kujtuar data e ngjarje nuk kemi si të mos ndalemi edhe te vitet e 90-ta.

Ishte ajo kohë kur punëtorët e arsimit shqip të Kosovës po përballeshin me dhunën e paparë të pushuesit, që donte të shuante shkëndijat e dijes shqip dhe të sillte mbi qiellin tonë errësirën. Këta pishtarë të dijes bashkë me nxënësit dhe popullin qëndruan dhe i dhanë shpirt dijes. I mbajtën në zemër shkronjat shqipe dhe kënduan guximshëm për trimat dhe betejat për liri.

Edhe në fillimet e marsit të vitit 2020 populli i Kosovës do të lartësojë kujtimin për Komandantin legjendar dhe për gjithë heronjtë e dëshmorët e kombit. Do të lartësojë kujtimin edhe për mësuesit tanë gjatë gjithë viteve e dekadave.

SBASHK-u do të vazhdojë me traditën e mirë për të bërë bashkë pishtarët e dijes dhe për t'i falënderuar me rastin e pensionimit të tyre për punën dhe përkushtimin nëpër vite e dekada në misionin e tyre të shenjtë për arsimimin dhe edukimin e brezave.

E gëzofshin pensionin!

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383 (0) 38/ 226 940



Intervista

Intervistë me zyrtaren për administratë në SBASHK, Afërdita Ahmeti

Respekti i ndërsjellë me anëtarët e SBASHK-ut më bën krenare



Afërdita Ahmeti është zyrtare administrative në SBASHK. Ajo çdo ditë angazhohet në komunikim me palët. Sjellja dhe përkushtimi në punë kanë bërë që ajo të gëzojë respekt meritator nga i tërë stafi, por edhe nga palët që vazhdimisht vijnë në selinë e SBASHK-ut.

“Respekti i ndërsjellë me stafin dhe anëtarësinë e SBASHK-ut me bëjnë krenare”, shprehet Afërdita në intervistën për këtë numër të “Arsimimi sot”.

Arsimimi sot:

Kush është Afërdita Ahmeti?

Afërdita:

Jam e lindur në Prishtinë. Shkollimin fillestar e kam përfunduar në shkollën “Ismajl Qemajli”, arsimin e mesëm në “Shtjefën Gjeqovi”. Pas kësaj kam kryer fakultetin në drejtimin për Administratë Publike. Në SBASHK punoj tani e 10 vite dhe këtu ndjehem si në familjen time. Stafi punon në atmosferë mirëkuptimi dhe i ndihmojmë njëri-tjetrit dhe kështu vazhdojmë të jemi në krye të detyrave dhe në shërbim të anëtarësisë.

Arsimimi sot:

Si ndjeheni duke kryer detyrat që kërkon vendi juaj i punës?

Afërdita:

Mundohem që të jem sa më e përpiktë në kryerjen e këtyre detyrave. Unë, veç tjerash, kujdesem që listat me anëtarë të rinj, që vijnë çdo ditë të jenë në sistem dhe të dërgohen me kohë edhe në Ministrinë gjegjëse. Po ashtu kujdesem që me kohë anëtarët e rinj të kenë kartelat e SBASHK-ut, që dëshmojnë kudo që është nevoja se ata janë anëtarë të sindikatës sonë. Po ashtu kryej edhe detyra të tjera dhe kurdo herë u ndihmoj kolegëve në punët e tyre sepse edhe ata kur kam shumë punë e angazhime më ndihmojnë mua. Këtu vërtetë jemi si një familje dhe kjo më bën të lumtur dhe krenare.

Arsimimi sot:

Thatë se komunikoni me kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe të Universiteteve. Si shkon ky komunikim?

Afërdita:

Gëzojmë respekt të ndërsjellë dhe kjo e lehtëson shumë angazhimin tim. Po ashtu edhe me palët që çdo ditë vijnë këtu në selinë e SBASHK-ut kam komunikim të qetë dhe mundohem t’u dalë në ndihmë. Ata na falënderojnë vazhdimisht për këtë.

Arsimimi sot:

Ju keni të bëni edhe me listat e anëtarësimeve të reja. Si po shkon ky proces?

Afërdita:

Po. Unë kam të bëj edhe me listat e anëtarësimeve të reja në SBASHK dhe me krenari e them se numri i anëtarëve të rinj sa vjen e shtohet. Kjo është dëshmi se SBASHK-u ka krijuar me punë, përkushtim e arritje besim te të punësuarit në arsim, shkencë e kulturë. Çdo ditë kemi anëtarësime të reja dhe kjo na shton edhe obligimet, por bashkërisht do ia dalim.

Arsimimi sot:

Përveç obligimeve nga vendi i punës, cili është aktiviteti më aktual i këtyre ditëve për ju dhe tërë stafin?

Afërdita:

I tërë stafi, pra edhe unë, këtyre ditëve jemi shumë të angazhuar në përgatitjet sa më të mira për Manifestimin kushtuar 7 Marsit. Po angazhohemi të gjithë bashkë aq sa mundemi e dimë me qëllim që Manifestimi të jetë sa më madhështor sepse këtë e meritojnë anëtarët e pensionuar të SBASHK-ut, të cilët do të jenë bashkë e në të njëjtën festë më 7 mars në Pallatin e sporteve “1 Tetori”. SBASHK-u ka përvojë të mirë në aktivitete dhe jam e sigurt se edhe në këtë Manifestim do të dalim faqebardhë. E gëzofshin pensionin dhe paçin jetë të gjatë gjithë ata kolegë tanë sindikalistë të arsimit, shkencës e kulturës, që janë pensionuar deri tani.

Gjatë muajit

Vizitë e Ministres Hykmete Bajrami në SBASHK

Angazhime të përbashkëta të MASHT-it dhe SBASHK-ut në shërbim të arsimit

Me të marrë të detyrës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria Hykmete Bajrami, e shoqëruar nga Këshilltari i lartë Lulëzim Krasniqi, ka vizituar selinë e SBASHK-ut. Ata janë pritur nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe udhëheqës të tjerë të SBASHK-ut.



Duke shprehur respektin e lartë këtë vizitë, kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala dhe menaxherin për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë informuar Ministren për sfidat dhe angazhimet aktuale për të kërkuar, veç tjerash, që të punohet lidhur me çështjen punëtorëve të arsimit me bashqellor 3 vjeçar, e që janë në sistemin arsimor. “Ju lusim të angazhoheni që të gjendjet zgjidhje e pranuar për ta”, janë shprehur përfaqësuesit e SBASHK-ut, të cilët në vazhdim të takimit kanë kujtuar Ministren se kjo sindikatë gjithmonë është angazhuar që çështjet të zgjidhen me dialog. “Jemi angazhuar vazhdimisht e nderuar Ministre që çështjet të gjejnë zgjidhje meritore me dialog, por ka ndodhur që pala tjetër nuk ka pasur të njëjtën qasje dhe prandaj kanë ndodhur edhe grevat, të cilat nuk kanë qenë dhe nuk janë dëshirë e SBASHK-ut, por veprohet

duke respektuar zërin e të punësuarve në arsim. Ka probleme të shumta në arsim dhe është mirë që të ketë takime të përbashkëta të MASHT, DKA- ve dhe SBASHK-ut për të debatuar shtruar për të gjithë çështjet në arsim dhe për të bërë angazhime të përbashkëta për tejkalimin e problemeve dhe sfidave”, janë shprehur përfaqësuesit e SBASHK –ut në takimin me Ministren Bajrami.



Ministrja ka deklaruar se gjithë çështjet e lidhura me arsimin në Kosovë do të diskutohen bashkërisht dhe bashkërisht edhe do të ketë angazhime të sinqerta për zgjidhjen e kërkesave të punëtorëve të arsimit, por edhe për shtimin e angazhimeve në të gjitha institucionet arsimore me qëllim që të ngritet cilësia dhe të përmirësohen kushtet e punës në shkollat tona. Ajo ka deklaruar se ka mjaft njohuri për punën dhe angazhimet e SBASHK-ut dhe ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në shërbim të arsimit. Në këtë takim është bashkëbiseduar edhe për trajnimet e organizuara nga SBASHK kudo në komunat e Kosovës me qëllim që punëtorët e arsimit të marrin njohuri të reja për t'i vënë në funksion të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim.

U mbajtën Kuvende pune në Obiliq dhe në Podujevë

Mirënjohje për arritjet, unik e të vendosur edhe në të ardhmen

Agjenda e përgatitur bashkërisht nga stafi qendror dhe kryetarët e niveleve sindikale komunale dhe të Universitetit ka nisur të realizohet të shtunën e 15 shkurtit me takime të ndara të punës së Kuvendeve

të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Kastriotit (Obliqit) dhe atë të Podujevës .

Pjesëmarrës në takimin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Kastriotit (Obliqit) ishin

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

edhe kryetari Rrahman Jasharaj dhe zyrtari ligjor i SBASHK-ut, Blendor Shatri.

Në fillimet e takimit kryetarja Boshnjaku ka shpalosur aktivitetet sindikale në këtë komunë duke kujtuar edhe sfidat nëpër të cilat kanë kaluar mësimdhënësit e Obiliqit gjatë grevës, por edhe pas saj. Ajo pastaj ka përshëndetur kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri duke i falënderuar për pjesëmarrjen në këtë Kuvend pune.



Pas kësaj kryetari i SBASHK-ut ka informuar anëtarët e këtij kuvendi për takimin me Ministren e MASHT, znj. Hykmete Bajrami, por ka folur edhe për aktivitetet dhe angazhimet që janë planifikuar të zhvillohen në të ardhmen duke kërkuar ide e propozime konkrete edhe nga pjesëmarrësit këtu. Kryetari Jasharaj ka informuar pjesëmarrësit e këtij takimi se duke u bazuar në qëndrimin e Këshillit Drejtues dhe në konsultim me kryetarët e Kuvendeve sindikale komunale ka marrë vendim që për shkak se kanë rënë në kundërshtim me Statutin e SBASHK-ut janë përjashtuar Xhavit Lani dhe Merushe Zeka, mësimdhënës të kësaj komune. "Duke filluar nga kryetari i SBASHK-ut e deri të anëtari i fundit do të përjashtohen nga radhët e SBASHK-ut nëse me veprimet e deklaratimet e tyre bien në kundërshtim me Statutin dhe qëndrimet e organeve legjitime të SBASHK-ut", ka theksuar kryetari Jasharaj. Disa nga anëtarët e këtij Kuvendi kanë kërkuar nga kryetari i SBASHK-ut që në takimin e radhës me Ministren Bajrami të diskutohet për kolegët e punuar në sistemin arsimor e që kanë bashqellor 3 vjeçar. Kryetari i SBASHK-ut është deklaruar se këtë çështje e ka

ngritur që në takimin e parë me Ministren në selinë e SBASHK-ut, por do të jetë temë e bisedës edhe në takimin e radhës me Ministren e MASHT-it, që pritet të ndodhë së shpejti.



Pjesëmarrësit në këtë takim kanë shtruar pyetje, që lidheshin me Kontratën Kolektive të Arsimit dhe kanë marrë përgjigje nga zyrtari ligjor i SBASHK-ut.

Kuvendi i suksesshëm pune edhe në Podujevë

Teksa anëtarët e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Kastriotit (Obiliqit) kanë vazhduar të diskutojnë e përcaktojnë detyra konkrete për angazhimet në nivel shkollash e në nivel komunal, kryetari i SBASHK-ut bashkë me zyrtarin ligjor kanë shkuar në Podujevë për të marrë pjesë në Kuvendin e punës të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë.



Në hapje të takimit kryetari i këtij Kuvendi Fadil Halimi ka falënderuar për pjesëmarrje kryetarin Jasharaj dhe juristin Shatri. Ai në vazhdim ka prezantuar një raport lidhur me angazhimet, arritjet dhe sfidat me të cilat janë përballur punëtorët e arsimit në këtë komunë. "Në Podujevë janë shënuar arritje të konsiderueshme mbështetur nga niveli



qendror dhe kjo ka bërë që të shtohet dukshëm numri i anëtarëve të SBASHK-ut nga kjo komunë. Në komunën tonë është krijuar një klimë mirëbesimi e bashkëpunimi në të gjitha nivelet sindikale deri në nivelin më të lartë të SBASHK-ut. Zatën kjo klimë e mirë ka bërë që të rritet edhe numri i anëtarëve të rinj në nivelin komunal deri në 1000 sish”, ka kujtuar Halimi.



Pjesëmarrësit kanë vlerësuar si shumë të qëlluar këtë aktivitet të takimeve me anëtarët e Kuvendeve

Agjendë për takime të Kuvendeve sindikale nëpër komunat e Kosovës

Bashkëbisedë me kryetarët e shoqatave sindikale



Një angazhim i veçantë për të cilin është debatuar dhe është arritur marrëveshje është agjenda e takimeve me anëtarët e Kuvendeve sindikale komunale dhe të Universiteteve dhe

pjesëmarrësit bashkërisht kanë saktësuar agjendën duke precizuar datat e mbajtjes së takimeve, në të cilat kudo në komunat e Kosovës dhe në Universitete, do të bashkëbisedohet me kryetarët e shoqatave e njëjse akademike në mënyrë që ata të përcjellin idetë e propozimet konkrete të anëtarësisë për angazhime konkrete, të paraqesin sfidat me të cilat po përballen anëtarësia në institucionet arsimore dhe pastaj të mbajnë takime me anëtarësinë me qëllim të informimit për të gjitha angazhimet. Takimet do të mbahen gjatë gjithë vikendeve, duke filluar nga e shtuna e 15 shkurtit, e deri në vikendet e fundit të muajit prill. Në këto takime do të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut nga niveli qendror.

sindikale komunale, por kanë kërkuar që të gjenet mundësia që të organizohen takime edhe nëpër shoqata sindikale me pjesëmarrjen e stafit nga qendra.

Në kuadër të punës së këtij Kuvendi pjesëmarrësit kanë shtruar edhe pyetje që lidheshin me Kontratën Kolektive të Arsimit dhe për mënyrën më të lehtë të arritjes së realizimit të disa të drejtave e benifiteve nga kjo Kontratë. Në këto pyetje është përgjigjur zyrtari ligjor i SBASHK-ut, Blendor Shatri.

Pas kësaj kryetari i SBASHK-ut bashkë me pjesëmarrësit kanë zhvilluar një bashkëbisedë duke u bazuar edhe në raportin e punës, që ka paraqitur kryetari Halimi. Pjesëmarrësit e këtij takimi kanë përcjellë edhe vlerësimin e anëtarësisë duke shprehur respekt për korrektësinë angazhimit dhe përkushtimin dhe në kuadër të kësaj kanë përcjellë edhe falënderimet e kolegëve tanë të pensionuar që kanë punuar në vitet e 90-ta për angazhimet e jashtëzakonshme të stafit të SBASHK-ut lidhur me Ligjin për statutin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta.

Plani për organizimin e Kuvendeve të punës së Sindikatave të Nivelit Komunal dhe Universiteteve

Nr	Sindikata Komunale dhe Universitare	Data	Ora
1	Obiliqi dhe Podujeva	15.02.2020	10:00, 11:00
2	Vushtri, Mitrovicë (Zveçani e Leposaviqi)	22.02.2020	11:00, 12:00
3	Peja dhe Deçani (Juniku)	29.02.2020	10:00, 11:00
4	Ferizaj dhe Vitia (Kllokoti)	14.03.2020	11:00, 12:00
5	Malisheva dhe Suhareka	21.03.2020	11:00, 12:00
6	Rahoveci dhe Gjakova	22.03.2020	11:00, 12:00
7	Kaçaniku dhe Hani i Elezit	29.03.2020	11:00, 12:00
8	Prizreni (Mamusha) dhe Dragashi	11.04.2020	10:00, 11:00
9	Gjilani dhe Kamenica	12.04.2020	11:00, 12:00
10	Drenasi dhe Skenderaj	18.04.2020	10:00, 11:00
11	Prishtina dhe Fushë Kosova	19.04.2020	10:00, 11:00
12	Klina dhe Istogu	25.04.2020	10:00, 11:00
13	Lipjani dhe Shtime	26.04.2020	10:00, 11:00
14	Novobërda		
15	Universitetet		
16	Shtërpce		

“Për të bashkëbiseduar nga afër për arritjet, shqetësimet, sfidat, por edhe për të pasur ide të përbashkëta për angazhimet në vijim, në takimin konsultativ me kryetarët e Kuvendeve Sindikale Komunale të Arsimit Parauniversitar dhe të Universiteteve është përkrahur ideja, që të përgatitet një agjendë e vizitave të kryetarit të SBASHK-ut dhe

stafit qendror në takimet e punës që do të organizohen kudo në komunat e Kosovës dhe në Universitete. Me qëllim që të mos pengohet procesi mësimor është arritur marrëveshja që këto Kuvende pune të organizohen gjatë vikendeve, gjegjësisht ditëve të shtuna dhe të diela”, ka sqaruar këtë aktivitet koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri.

Realizimi i kësaj agjende ka nisur të shtunën e 15 shkurtit me takimet e organizuara në Kastriot (Obiliq) dhe në Podujevë, për të vazhduar pastaj të shtunën e 22 shkurtit në Vushtrri e Mitrovicë.

U mbajt takim konsultativ me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve

Marrëveshje për angazhime të përbashkëta sindikale

Është mbajtur në Sallën e takimeve të Qendrës së Studentëve takimi i rregullt konsultativ me kryetarët e Kuvendeve Sindikale të Arsimit Parauniversitar dhe të Universiteteve me qëllim që të krijohet një plan i angazhimit të përbashkët në vijim për aktivitetet sindikale të SBASHK-ut.



Në hapje të këtij takimi të pranishmit me një minutë heshtje kanë nderuar kujtimin për veprën dhe jetën e emblemës së këngës shqipe në Kosovë, Nexhmije Pagarusha. Pasi pjesëmarrësit kanë aprovuar rendin e punës kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka informuar lidhur me rrjedhën dhe përmbajtjen e takimit me Ministren e MASHT, znj. Hykmete Bajrami. “Takimi ishte përmbajtjesor dhe se të dy palët jemi shprehur të gatshëm për bashkëpunim në përballje me sfidat e kohës në arsim, për realizimin e kërkesave legjitime të punëtorëve të arsimit dhe për përkushtimin në ngritjen e cilësisë në arsim”, është shprehur kryetari Jasharaj.

Takime pune të Kuvendeve Sindikale komunale do të vazhdojnë të mbahen edhe në vikendet tjera gjatë gjithë marsit dhe prillit sipas datave të përcaktuara në agjendë e duke mos përjashtuar në të ardhmen as të dielat. Do theksuar se bazuar në deklaratimet e pjesëmarrësve në katër takimet e mbajtura deri tani ky është një aktivitet shumë i qëlluar sepse në to po bashkëbisedohet me kryetarët e shoqatave sindikale për shumë çështje aktuale dhe po caktohen angazhime e detyra konkrete për udhëheqësit sindikal në nivel shoqatash, komunash e pastaj edhe për ata të nivelit qendror.



Pas kësaj janë caktuar edhe detyra konkrete për çështje të rëndësishme dhe pastaj është bërë edhe një analizë e përgatitjeve deri tani për Manifestimin kushtuar 7 Marsit. “Stafi në qendër i udhëhequr nga koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri ka bërë përgatitje fillestare dhe po vazhdon angazhimet me përkushtimin. Nga shënimet shihet se janë më shumë se 700 kolegë tanë që pensionohen prilli i vitit të kaluar e deri në prillin e këtij viti dhe duke vazhduar traditën e mirë SBASHK-u për ta do të organizojë Manifestimin kushtuar ditës së madhe të shkollës shqipe dhe mësuesit në Pallatin e sporteve “1 Tetori” në Prishtinë. Do të jetë ky një moment plot emocione kur punëtorët e pensionuar të arsimit në këtë interval kohor do të jenë bashkë në një atmosferë festive e plot emocione dhe do të marrin mirënjohje dhe nga një orë me emblemën e SBASHK-ut në shenjë respekti për angazhimin e tyre nëpër vite e dekada për arsimimin dhe edukimin e brezave. Në këtë Manifestim pritet të jenë të pranishëm edhe udhëheqësit më të lartë të

institucioneve të shtetit tonë, por edhe mysafirë të nderuar nga Shqipëria dhe trojet tjera etnike”, ka informuar të pranishmit kryetari i SBASHK-ut.



Në vazhdim të këtij takimi konsultativ është diskutuar edhe për vazhdimin e organizimit të trajnimeve nga

SBASHK nëpër komunat e Kosovës dhe pjesëmarrësit janë pajtuar që kryetarët e nivelit komunal të vazhdojnë me angazhimin dhe përkushtimin në mënyrë që përgatitjet për mbajtjen e trajnimeve të bëhen me kohë dhe rrjedha e tyre të përcillet nga vetë kryetarët e nivelit komunal.

Edhe në këtë takim kryetarët e Kuvendeve të nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve kanë përsëritur vendimin dhe kanë qenë kategorik që cili do që shkel Statutin e SBASHK-ut dhe që me angazhime e deklarime bie në kundërshtim me vendimet e organeve legjitime dhe me çështjet që përcakton qartë Statuti i aprovuar nga delegatët e Kongresit, më datën 24 shkurt 2018, të përjashtohen nga sindikata jonë.

Vazhdon realizimi i agjendës së takimeve nëpër komunat e Kosovës

Kuvende pune në Vushtrri e në Mitrovicë

Ka vazhduar realizimi i agjendës së takimeve të Kuvendeve sindikale komunale. Në vikendin e së shtunës, më 22 shkurt me takimet në Vushtrri e Mitrovicë.

Takimin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Vushtrrisë e ka hapur kryetari për këtë komunë Alush Maloku. Ai fillimisht ka përshëndetur dhe ka falënderuar për pjesëmarrje në këtë takim kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, nënkryetaren Vjollca Shala, menaxherin për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe zyrtarin ligjor të SBASHK-ut, Blendor Shatri.



Kryetari Maloku pastaj ka bërë një raport të angazhimeve sindikale në këtë komunë për t'u ndalur te organizimi dhe realizimi i shumë trajnimeve për

kolegët tanë në këtë komunë. “Kujtoj tani veçmas ditët e grevës unike të janarit të vitit 2019 dhe unitetin e shkëlqyer në këtë komunë gjatë dhe pas grevës, unitet ky që vazhdon edhe tani e gjithmonë. Shpreh edhe në emrin tuaj respekt për angazhimet e kryetarit dhe tërë stafit qendror, angazhim e përkushtim ky, që si tha Maloku, ka ndikuar që të shtohet vazhdimisht besimi në SBASHK”, është shprehur kryetari Maloku.



Kryetari Rrahman Jasharaj bashkë me përfaqësues të tjerë të SBASHK-ut pas kësaj kanë nisur bashkëbisedën me anëtarët e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Vushtrrisë duke treguar për çështjet e ngritura e të debatuar në takimin e parë me Ministren e MASHT, Hykmete Bajrami e pastaj u janë përgjigjur pyetjeve të shtruar nga pjesëmarrësit. Anëtarët e këtij Kuvendi janë shprehur të kënaqur me angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut

e po ashtu edhe kanë dhënë ide konkrete për angazhimet e aktivitetet në vijim.

Takim i përgatitur mirë në Mitrovicë

Nga Vushtrria kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj i shoqëruar nga zyrtari ligjor Blendor Shatri kanë shkuar në Mitrovicë, teksa nënkryetarja Vjollca Shala dhe menaxheri për finca e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë vazhduar bashkëbisedën me kryetarët e shoqatave sindikale në Vushtrri.

Në hapje të takimit në Mitrovicë kryetari për këtë komunë, Isa Ismajli ka përshëndetur dhe ka falënderuar për pjesëmarrje kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri. “Në komunën tonë janë zhvilluar shumë aktivitete sindikale në koordinim e mbështetje të SBASHK-ut nga qendra. Kemi treguar unitet dhe përkushtim në realizimin e kërkesave tona dhe vlerësojmë lart angazhimin e kryetarit dhe stafit nga qendra dhe qëndrimin e tyre përball sfidave. Ky qëndrim na ka dhënë kurajë dhe ka shtuar besimin e anëtarësisë në SBASHK-un. Kemi shënuar arritje edhe në organizimin e mirë të trajnimeve , të cilat janë në shërbim të anëtarësisë dhe krijojnë mundësi për të marrë njohur të reja dhe për të arritur një numër sa më të lart të orëve të trajnimeve që kërkohen për licencë, por edhe për të nisur me procesin e gradimeve”, është shprehur kryetari Ismajli.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka lavdëruar kryetarët e shoqatave sindikale nga kjo komunë për pjesëmarrjen në këtë takim dhe pastaj ka

informuar ata për rrjedhën e takimit me Ministren e MASHT, Hykmete Bajrami duke përmënuar veç tjerash se është ngritur çështja e kolegëve tanë me 180 kredi dhe çështje të tjera, që në të vërtetë janë qëndrime të njohura të SBASHK-ut bazuar në zërin dhe kërkesat e anëtarësisë.

Pas kësaj është zhvilluar një bashkëbisedë përmbajtësore dhe pjesëmarrësit fillimisht kanë shtruar pyetje të shumta, në të cilat janë përgjigjur kryetari Jasharaj dhe zyrtari ligjor Shatri. Temë e bashkëbisedës kanë qenë edhe trajnimet e organizuara gjatë vitit të kaluar dhe ato që planifikohen të organizohen këtë vit , një pjesë e të cilave do të jenë të mbështetura nga SBASHK, sipas vendimit të Këshillit Drejtues dhe kryetarëve të nivelit komunal sindikal dhe Universiteteve.

Kryetari Jasharaj në fillim të fjalës së tij ka shprehur respekt për angazhimin e kryetarit të nivelit komunal Isa Ismajli, të kryesisë këtu, por edhe të gjithë anëtarësisë duke theksuar se Mitrovica është një shembull i mirë i unitetit dhe përkushtimit sindikal e pastaj ka vazhduar bashkëbisedën duke shtuar:

“ Ju lus kolegë e kolege të lexoni vazhdimisht e çdo ditë ueb faqen e SBASHK-ut dhe informacionet e publikuara nga zyra për informim e sindikatës sonë dhe ato t’i përcillni te anëtarësia. Me anëtarësinë duhet zhvilluar takime e debate për angazhimet, arritjet dhe sfidat në të kaluarën, por edhe për të ngritur ide për angazhimet dhe punën në vijim. Lidhur me trajnimet dua t’ju kujtoj se ato i kemi licencuar në MASHT dhe jemi duke i organizuar me shumë mundësi përkushtim me qëllimin e vetëm që t’ju dalim në ndihmë kolegëve tanë që ata të marrin njohuri të reja nga sferat gjegjëse, por edhe të arrijnë numrin e duhur të orëve të trajnimit , që kërkohen për përtëritjen e licencës së punës, por edhe për të qenë sa më të gatshëm për fillimin e procesit të gradimit. T’u thoni qartë kolegëve tanë nëpër shkolla se trajnimet e organizuar nga SBASHK-u nuk janë obligative, por në to shkohet me dëshirë”, është shprehur kryetari Jasharaj. Pas kësaj zyrtari ligjor Blendor Shatri u është përgjigjur pyetjeve të shtrura nga pjesëmarrësit , të cilët lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut duke shprehur mbështetjen për angazhime edhe në të ardhmen.

Një takim i rëndësishëm i sindikalisteve nga Evropa

Angazhim i përbashkët për barazinë e të gjithëve

Komiteti i ETUCE-së për Barazi është takuar më 27 dhe 28 shkurt. Në këtë takim mori pjesë Vlora Rexhepi Berisha, përfaqësuese e SBASHK-ut në këtë Komitet, e cila përveç takimit zyrtar, pati mundësinë të takohet dhe të bisedoj edhe me koleget nga sindikata të ndryshme evropiane, pjesëmarrëse në këtë takim.

Takimin e hapi Rosella Benedetti, kryetare e këtij Komiteti, ku pastaj Kryetarja e ETUCE-së Christine Blouer përshëndeti pjesëmarrësit duke iu kujtuar se jemi këtu për barazi në gjitha fushat. Studentët dhe nxënësit e Evropës janë jashtëzakonisht të larmishëm, dhe kështu janë mësuesit dhe personeli arsimor që punojnë me ta. Kjo është arsyeja pse sindikatat e arsimit në të gjithë rajonin evropian po punojnë së bashku për të promovuar mundësi të barabarta për të gjithë.



Ndërsa drejtorja evropiane për ETUCE, Susan Flocken, foli më gjerësisht për temën kryesore, që u diskutua gjatë këtyre dy ditëve e që ishte zbatimi i Planit të ri të Veprimit për Barazi Gjimore ETUCE. Ajo njoftoi pjesëmarrëset për materialet e ETUCE-së si dhe për konferencën për barazi që do të zhvillohet në dhjetor 2020.

Takimin e përshëndeti edhe zëvendëse Sekretarja e Përgjithshme e EI-së, Haldis Holst, e cila foli për deklaratën mbi sigurinë dhe respektin, të hartuar nga

EI, deklaratë kjo e shtjelluar gjatë Kongresit të EI-së në Bangkok. Ajo po ashtu potencoi se këtë herë Kongresi për herë të parë ka zgjedhur më shumë gra në pozita udhëheqëse, në Bordin Ekzekutiv të EI-së, gjë që është një hap shumë i mirë drejt barazisë gjinore. Znj. Holst, foli edhe për Konventën e ILO-së mbi ngacmimet, e cila duhet të ratifikohet, pasi që është shumë e rëndësishme për të gjithë të punësuarit.



Ekaterina Efimenko, diskutoi mbi përpilimin e draftit të planit të veprimit si dhe zhvillimin e politikave të BE-së. Po ashtu tregoi edhe për hulumtimin e bërë sipas viteve mbi barazinë dhe të drejtat dhe “ Qe nga viti 2005 deri në vitin 2019 nuk është vërejtur ndonjë rritje e madhe dhe prandaj kemi ende punë për të bërë.

Është paraqitur me diskutim edhe Esther Lynch, zëvendëse Sekretarja e Përgjithshme nga ETUC, në një panel diskutimi mbi lidhjen midis politikës dhe përfshirjes. Ajo shpalosi edhe çështjen e martesës së dhunshme të femrave të reja në Stamboll

Në këtë takim janë mbajtur edhe seanca në të cilat u bë plotësim ndryshimi i disa pikave të planit të veprimit për barazi, diversitet dhe përfshirje.

Vazhdon të realizohet agjenda e takimeve nëpër komuna

Kuvende punë në Pejë e në Deçan

Ka vazhduar se realizuari agjenda për takimet e Kuvendeve të punës së sindikatave të Arsimit Parauniversitar nëpër komunat e Kosovës. Në vikendin e 29 shkurtit takime të tilla janë mbajtur në Pejë e në Deçan

Kuvendi i punës në Pejë është mbajtur në shkollën “Xhemajl Kada”. Në hapje të këtij takimi kryetari për këtë komunë Isuf Lajçi, ka përshëndetur fillimisht kryetarin Rrahman Jasharaj dhe zyrtarin ligjor të SBASHK-ut, Blendor Shatri. Kryetari Lajçi pas kësaj ka prezantuar një raport pune duke u ndalur në momentet e veçanta të aktivitetit sindikal në këtë komunë.



“Anëtarësia e SBASHK-ut në Pejë ka dëshmuar unitet. Puna dhe përkushtimi i nivelit qendror ka bërë që të krijohet një besim i fortë në sindikatën tonë dhe ky besim jam shumë i sigurt do të ruhet e forcohet edhe në të ardhmen”, është shprehur Lajçi.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka lavdëruar angazhimin e kryetarit Lajçi dhe kryesisë. “Duhet të vazhdoni me unitetin dhe angazhimet në shërbim të anëtarësisë. Kryetarët të mbajnë takime me anëtarësinë në gjithë shoqatat sindikale me qëllim që ata të informohen nga afër për angazhimet, sfidat dhe arritjet, por edhe të merren ide nga ata për angazhimet në vazhdim. Do të vazhdohet edhe me trajnimet. Këshilli Drejtues ka lejuar mjete që të mbulohen trajnime për 20 % të anëtarësisë se një

komune . Duhet pasur kujdes të vazhdueshëm në mënyrë që trajnimet të organizohen në nivel të lartë dhe të përcillet rrjedha e tyre nga kryetarët e nivelit komunal”, ka kujtuar kryetari Jasharaj, i cili pastaj ka dhënë informacione nga angazhimet e nivelit qendror duke përmendur takimin me Ministren Bajrami e për të vazhduar edhe me aktivitete e sfidat aktuale. Anëtarët e këtij Kuvendi kanë shprehur shqetësimin e anëtarësisë që përfaqësojnë lidhur me lajmin, që është shpërndarë aty e këtu se ekziston mundësia që Ministria e Financave të mos planifikojë mjete buxhetore për Ligjin e pagave në Ligjin e buxhetit 2020. Ata janë shprehur se po përgatiten që të nisin edhe me veprime sindikale nëse kjo vërtetë ndodh.

Pjesa e dytë e këtij takimi është zhvilluar në formë të bashkëbisedave dhe zyrtari ligjor Blendor Shatri është përgjigjur në shumë pyetje të pjesëmarrësve.

Kuvend pune edhe në Deçan

Në ambientet e Gjimnazit “Vëllezërit Frashëri të Deçanit është mbajtur Kuvend pune i Sindikatës së Arsimit parauniversitar për këtë komunë.

Duke nisur me punimet e këtij kuvendi kryetari për këtë komunë Burim Avdijaj ka përshëndetur e falënderuar për pjesëmarrje kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri. Ai pastaj ka bërë një prezantim të aktiviteteve sindikale që janë zhvilluar në këtë komunë.



Në fillim të fjalës së tij kryetari Jasharaj ka përgëzuar drejtorinë dhe të punësuarit e këtij

institucioni arsimor që me angazhime e përkushtim kanë arritur të krijojnë një ambient prej një vatre të vërtetë arsimore. Kryetari Jasharaj në fillim ka shprehur kënaqësinë për ambientet e bukura dhe të mbajtura me kujdes të Gjimnazit duke përgëzuar drejtorin dhe të punësuarit në këtë institucion arsimor, në sallën e të cilit po mbahej takimi. “Përgëzoj gjithë anëtarët e SBASHK-ut në Deçan për unitetin dhe përkushtimin. Ne do të vazhdojmë bashkërisht angazhimet në shërbim të anëtarësisë. Unë e kuptoj shqetësimin e anëtarësisë lidhur me lajmin se Ministria e Financave mund të mos bëjë planifikim buxhetor për implementimin e Ligjit të pagave në

Ligjin e buxhetit. Ne do të vazhdojmë me angazhimin. Do të vazhdojmë të jemi zë i anëtarësisë dhe do të veprojmë me përpikëri në realizimin e kërkesave dhe do të veprojë ashtu si vendosin anëtarësia”, ka thënë kryetari Jasharaj.

Pjesëmarrësit kanë shtuar edhe pyetje që kishin të bënin me Kontratën dhe çështje të tjera dhe në to është përgjigjur zyrtari ligjor Blendor Shatri. Në këtë takim është biseduar edhe për përgatitjet lidhur me Manifestimin kushtuar 7 Marsit dhe është thënë se është ky një moment i mirë kur të pensionuarit nga e tërë Kosova do të jenë bashkë në festën e shkollës shqipe.

SBASHK-u takim në Tiranë me përfaqësues të Sindikatave shqiptare të Arsimit Ide përmbajtjesore për forcimin e bashkëpunimit sindikal

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, duke iu përgjigjur ftesës së Federatës së Sindikatës së Arsimit të Shqipërisë (FSASH) ka qëndruar në Tiranë bashkë me menaxherin për financa e administratë dhe koordinator për bashkëpunim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe me zyrtarin ligjor Blendor Shatri duke zhvilluar takime me përfaqësues të sindikatave shqiptare të arsimit.



Kryetari i nderit i FSASH, prof. dr. Xhafer Dobrushit ka shprehur kënaqësinë për këtë vizitë dhe pastaj ka bërë një pasqyrim të situatës aktuale në arsimin shqiptar duke u ndalur te aktivitetet, por edhe te sfidat e shumta që ka kjo sindikatë në angazhimet për realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Të dy palët pastaj në një bashkëbisedë vëllazërore kanë shkëmbyer ide dhe kanë folur për aktualitetin në Shqipëri e Kosovë për t’u ndalur veçmas në sektorin e arsimit dhe në aktivitetet sindikale. Ata janë pajtuar

se duhet shtuar aktivitetet dhe takimet e përbashkëta duke mundësuar kështu që të barten përvojat, por edhe të krijohet një plan i përbashkët i veprimtari në situata të caktuara dhe në përballje me sfidat. Ata kanë kujtuar se gjithmonë këto sindikata janë solidarizuar dhe i kanë dhënë përkrahje e mbështetje njëra-tjetrës në situata protestash a grevash, por janë konsultuar gjithmonë edhe gjatë takimeve ndërkombëtare me qëllim që të kenë prezantime sa më të dinjitetshme atje.

Në këtë takim ka marrë pjesë edhe nënkryetari i SPASH, Isa Halili, i cili është shprehur i nderuar me këtë vizitë dhe ka përsëritur gatishmërinë e sindikatës që përfaqëson për të vazhduar bashkëpunimin me SBASHK-un duke u pajtuar se duhen organizuar takime e Konferenca me përfaqësues të sindikatave shqiptare dhe të SBASHK-ut për të debatuar për të gjitha çështjet dhe për të përgatitur edhe një plan të aktiviteteve për të ardhmen. Përfaqësuesit e Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë dhe ata të SBASHK-ut janë pajtuar që së shpejti të organizojnë takim pune me pjesëmarrjen udhëheqësve sindikal, por edhe të veprimtarëve e njohësve të mirë të sindikalizmit dhe të debatohet për gjithë çështjet aktuale duke nxjerr edhe Konkluzione, që do të jenë bazë e mirë e angazhimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta sindikale.